



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Dhjetor 2021

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Dhjetor 2021

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në edicionin e përmuajshëm të këtij buletini pasqyrohen aktivitetet për muajin dhjetor të vitit 2021)

Trajtimi i lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, prioritet i Prokurorisë Themelore të Pejës

Komisioni për Administrimin e Prokurorive dhe Grupi punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizitoi Prokurorinë Themelore të Pejës, ku u kërkua një përkushtim më i madh në zvogëlimin e numrit të lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike dhe trajtimin e tyre me prioritet të lartë. Kjo vizitë është realizuar në kuadër të monitorimit të proceseve të punës nëpër prokuroritë e vendit.



Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KPK-së mbajti takimin e radhës, me ç'rast shqyrtoi shpenzimet për kategoritë ekonomike të buxhetit në secilin program buxhetor të KPK-së, me fokus të veçantë në shpenzimet kapitale për vitin 2021.



Komisioni ka aprovuar edhe ndryshimet që duhet të bëhen deri në fund të vitit në buxhetin e KPK-së.

KPK-ja dhe Ambasada e SHBA-së diskutojnë për projektet e reja të digjitalizimit të sistemit prokurorial

Kryesuesi i KPK-së priti në takim përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Kosovë, me ç'rast u prezantuan projekte të reja, qëllimi kryesor i të cilave



është digjitalizimi i plotë i proceseve të punës, duke transformuar procesin e punës manuale në atë elektronike, gjë që do të mundësojë vënien në dispozicion të shërbimeve digjitale për Këshillin Prokurorial dhe Prokurorin e Shtetit.

Finalizohet drafti i Rregullores për zgjedhjen dhe përfundimin e mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së dhe Drejtorit të NJSHP-së

Komisioni për Çështje Normative të KPK-së finalizoi draftin e Rregullores për zgjedhjen dhe përfundimin e mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së dhe Drejtorit të NJSHP-së, i cili qartëson çështjet e zgjedhjes, vlerësimit dhe përfundimit të mandatit të dy zyrtarëve më të lartë të administratës së sistemit prokurorial të Kosovës.



Mbahet takimi i 206-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

KPK-ja miratoi Raportin periodik janar-shtator 2021 për veprat penale karakteristike të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional, Raportin për rivlerësimin e performancës së një prokurori, Raportin për vlerësimin e performancës së 10 prokurorëve dhe ka miratuar pjesërisht Raportin për vlerësimin e performancës së 12 prokurorëve, si dhe caktoi Udhëheqësin e Zyrës për Komunikim Publik të KPK-së, Astrit Kolaq, zyrtar të ri për Qasje në Dokumente Publike të sistemit prokurorial të Kosovës.



Mbahet punëtori për hartimin e draftit të Planit strategjik për vitet 2022-2024 të sistemit prokurorial

KPK-ja, e mbështetur nga Programi i BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë, EUKOJUST, mbajti një punëtori për hartimin e draftit të Planit Strategjik 2022 – 2024 të sistemit prokurorial, me ç'rast një rëndësi e veçantë iu kushtua planifikimit të politikave për menaxhimin e sistemit prokurorial në tre vjetët e

ardhshëm, me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të



profesionalizmit, efikasitetit dhe fuqizimit të pavarësisë, integritetit, llogaridhënies dhe transparencës, duke u mbështetur në kompetencat kushtetuese dhe ligjore.

Opinioni i Komisionit të Venecias siguron pavarësinë e sistemit prokurorial

KPK-ja ka mirëpritur opinionin e Komisionit të Venecias lidhur me draft-amendamentimin e Ligjit për KPK-në.



Në një deklaratë për media, KPK-ja ka thënë se ky opinion siguron ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë e sistemit prokurorial, duke ritheksuar se iniciativat e ndërmarra nga Ministria e Drejtësisë për të ndryshuar Ligjin për KPK-në me këto propozime janë në kundërshtim me praktikat dhe standardet ndërkombëtare.

Maloku dhe Lumezi vizitojnë institucionet e drejtësisë në Strasburg

Kryesuesi i KPK-së dhe Kryeprokurori i Shtetit zhvilluan një vizitë në Strasburg, ku u takuan me përfaqësuesit e Këshillit të Evropës, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komisionarin për të Drejtat e Njeriut dhe Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (CPT), me të cilët diskutuan për interpretimin e konventave të ndryshme evropiane, punën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, zbatimin e

vendimeve të GJNDNJ-së dhe praktikat e saj të mira, bashkëpunimin me vendet anëtare të KE-së në luftën kundër torturës dhe në mbështetje të sistemit të



drejtësisë penale, rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues dhe transformimet digjitale të institucioneve gjyqësore dhe prokuroriale.

Prezantohet Raporti i i EULEX-it për monitorimin e Drejtësisë në Kosovë

Zëvendëskryesuesi i KPK-së mori pjesë në publikimin e Raportit të monitorimit të drejtësisë nga Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit, EULEX, për periudhën mars-tetor 2021, me ç'rast tha se sistemi prokurorial është falënderues për monitorimin sistematik dhe tematik nga ana e EULEX-it të rasteve të zgjidhura penale dhe civile, përfshirë rastet e profilit të lartë.



Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel aprovoi Planin e prokurimit për vitin 2022

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KPK-së, mbajti takimin e radhës, në të cilin diskutoi për Planin e prokurimit për vitin 2022, duke e aprovuar në parim



me ndryshimet e identifikuara, të cilat duhet të përfshihen në versionin final të tij.

Mbahet testi me shkrim i kandidatëve për prokurorë të shtetit

Në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtri u mbajt testi me shkrim i kandidatëve për prokurorë të shtetit në kuadër të procesit rekrutues të 16 prokurorëve në prokuroritë themelore, ku morën pjesë



180 kandidatë, prej të cilëve 62 kandidatë të gjinisë femërore, kurse një nga radhët e komuniteteve joshumicë. Procesi i rekrutimit të prokurorëve ka filluar me shpalljen e konkursit në qershor të vitit 2020 dhe me rishpalljen e tij në maj të vitit 2021.

Vlerësohet lart sistemi prokurorial për respektim të barazisë gjinore, përfshirje, diversitet dhe përfaqësim të barabartë

Kryesuesi i KPK-së, Zëvendëskryeprokurorja e Shtetit dhe Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, morën pjesë në prezantimin e Raportit për vlerësimin e përfshirjes institucionale në aspektin gjinor

dhe social të sistemit prokurorial të Kosovës, i hartuar nga përfaqësuesit e Projektit britanik "Forcimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë", ku KPK-ja dhe Prokurori i Shtetit u vlerësuan lart sa i përket barazisë gjinore, përfshirjes, diversitetit dhe përfaqësimit të barabartë.



Mbahet takimi i 207-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

KPK-ja mbajti takimin e 207-të, në të cilin miratoi këto akte: Rregulloren për menaxhimin e lëndëve përmes sistemit elektronik (SMIL) në sistemin prokurorial, Udhëzuesin themelor të referimit për organet paratetuese dhe hetuese disiplinore për prokurorët,



Planin e punës së Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve për vitin 2022 dhe Raportin për vlerësimin vjetor të eprorëve për vitin 2020, si dhe katër raporte për vlerësim dhe rivlerësim të 25 prokurorëve.

Kryesuesi Maloku ka prezantuar punën njëvjeçare të KPK-së

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial mbajti konferencën e fundvitit për media, në të cilën prezantoi veprimtarinë njëvjeçare (2021), rezultatet dhe sfidat e Këshillit, me të cilat është ballafaquar gjatë realizimit të mandatit të tij, si dhe planifikimin për vitin 2022. Për më tepër, fjalën e plotë të Kryesuesit Maloku e gjeni në linkun: <https://www.prokuroria-rks.org/kpk/lajm/7848>



Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

SKPK-së zhvilloi aktivitete të ndryshme, ndër të cilat veçojmë: përfaqësues të SKPK-së vizituan Prokurorinë Themelore të Ferizajt për të monitoruar procesin e zbatimit të rekomandimeve për DBNJ-së dhe DSHP-ë dhe dha komente në Draftmarrëveshjen për asgjësimin e pasurisë jofinanciare të SPRK-së, duke kontribuar në mbarëvajtjen e procesit të rekrutimit të kandidatëve për prokurorë të shtetit.

Gjithashtu, SKPK-ja ofroi mbështetje dhe dha kontribut në një punëtori për Planin strategjik të sistemit prokurorial për periudhën 2022-2024 dhe monitoroi procesin e zbatimit të rekomandimeve në raportet finale për njësitë e audituara të SP-së, si dhe përgatiti Planin strategjik të NJAB-së për vitet 2022-24.

Vlen të theksohet veçanërisht se SKPK-ja mbajti takime me përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe me përfaqësues të Projektit EUKOJUST për të diskutuar financimin e projekteve për të gjitha prokuroritë, projekte këto që këto projekte priten të implementohen gjatë vitit 2022.

Në kuadër të bashkëpunimit me donatorë është mbajtur një takim me Drejtorin e Zyrës Ndërkombëtare për Narkotikë dhe Çështje të Zbatimit të Ligjit në Ambasadën Amerikane, me ç'rast janë prezantuar nevojat dhe projektet për financim në fushën e Teknologjisë Informative, ndërtimin e Qendrës së të Dhënave, sistemit elektronik për transkriptim, furnizimit me pajisje etj.

Në bashkëpunim me përfaqësuesit e UNDP-së dhe ASHI-së filloi implementimi i enkriptimit të të dhënave gjatë komunikimit zyrtar, ndërsa në bashkëpunim me anëtarët e Grupit të Komitetit për Siguri Kibernetike është përgatitur drafti i parë i Strategjisë së Sigurisë Kibernetike dhe Plani i Veprimit.

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

Njësitë për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë është fokusuar në hartimin e Raportit nëntëmujor të punës së Prokurorit të Shtetit, Raportit analitik për ngarkesën e prokurorëve me lëndë dhe numrin e nevojshëm të prokurorëve në prokurori, Raportit për efikasitetin e prokurorëve në nëntëmujorin e vitit 2021, përgatitjen e informatave dhe raporteve në kompetencë të ZMAVP-së për komisionet dhe mekanizmat e tjerë të sistemit prokurorial.

Gjithashtu gjatë muajit dhjetor grumbulloi të dhëna statistikore dhe përpiloi pasqyra për ngarkesën me lëndë dhe efikasitetin në zgjidhjen e tyre, sipas regjistrave: PP, PPM, PPN, PPP dhe NJN, për secilin prokuror veç e veç, pastaj edhe ato për gjendjen e rasteve nëpër prokurori sipas këtyre regjistrave.

Rrjedhimisht, vlen të përmendet, se në aspektin e ngritjes së kapaciteteve profesionale u realizuan trajnime të shumta nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme për prokurorë dhe stafin administrativ, siç janë: “E drejta e azilit dhe legjislativi në fuqi”, “Unifikimi i praktikave të prokurorisë në aplikimin e Ligjit të ri për të Mitur”, “Evidencat penale”, “Menaxhimi i stresit”, “Përgjegjësitë penale të personave juridikë” dhe “Parandalimi i Torturës – Neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.